



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është përfekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“BLERJE MATERIALE MEKANIKE ”, Procedurë e hapur e thjeshtuar - mallra, me afat sipas kërkesave të AK”

VLERA E FONDIT LIMIT: 1.558.520 (Nje milion e peseqind e pesedhjete e tete mijë e peseqind e njezet

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkoder sha, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve përkualifikim për procedurën e sipërcituar, me përbajtjen si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Specifikime teknike
1	Disk gure flesibel preres metali	ø230x2x22,23 mm
2	Disk diamanti preres betoni	ø 400mm
3	Disk diamanti preres betoni	ø 230x3x22,5 mm
4	Disk diamanti preres asfalti	ø 400mm
5	Disk diamanti preres asfalti	ø 230mm
6	Disk zmerilues banaku grana	grana 60 200x20x20 mm.
7	Elektroda transformatori	ɸ 2.5 mm (SAF.FRO E60-13)
8	Elektroda transformatori	ɸ 3.2 mm (SAF.FRO E60-13)
9	Boje zmalto	
10	Furce boje	Rula boje qelesheje l=60mm.d=30mm
11	Diluent	1 lt
12	Ngjites 2 komponentesh 25 ml.	Ngjites profesional per bashkimin e pjeseve te ndryshme metalike.

		Përdoret edhe nën ujë. Rezistent ndaj ujit, naftës, yndyrat dhe alkool. Universal - ngjitës druri, plastikë, pleçikllas, plastikë, metal, qelq, porcelan, qeramikë, lëkurë, gomë, pëlhirë, karton dhe letër.
13	Ngjites universal transparent 42 gr.	
14	Sprajt kunder korruzionit	200 ml
15	Spraj graso litiumi	200 ml
16	Spraj pastrues frenash	500 ml
17	Spraj pastrues elektrik	400 ml
18	Silikon testate	
19	Izolues gome	250 mg
20	Shirit kufizimi,	70 mm x 200 m, ngjyra e verdhe me te zeze
21	Shirit ngjites -25ml	per materiale gome.plastike etj. Temperatura max grade (Rula)
22	Litar -d=12 mm	Materiali Poliaster, ,Rezistent ndaj ujit vajit naftes.
23	Litar -d=14 mm	Materiali Poliaster, i zi,Rezistent ndaj ujit vajit naftes.
24	Tapet gome	(per hermetizim)
25	UP-16	Materiali inox.
26	UP-14	Materiali inox.
27	Kallaj	
28	Paste per kallaisje	
29	Mentesha te medha	Saldim 200 mm
31	Vida veteshpuese (puntovidë)	d=8mm l=50mm
32	Profil celiku (ele)	L-40X40X4
33	Profil celiku	KATROR -30X30X2 m spesor
34	Spraj kundër ndryshkut	
35	Boje vaji	Boje vaji (lyerje rrrethoje e kaptazhit) ngjyre kuqe, ngjite shumë të mirë me sipërfaqen si dhe rezistencë të lartë ndaj agjentëve atmosferike dhe kimik
36	Boje vaji per metale 0.75 L	Përdoret për mbrotjen e të gjithave sipërfaqeve metalike
37	Boje antiruxho 0.75 L	Gaz për shkrirjen e tubacioneve
38	Gaz	Tel çeliku Ø 10
40	Fishek për dyer të blinduara	Bronz i nikeluar, 70 mm
41	UPA 10-she	
42	Disk metali	Disk prerës për çelik 115x1mm
43	Disk diamanti 115x7x22	Disk me dhëmbë diamant për prerjen e granitit, betonit,mermerit, tubave të betonit etj, falë dhëmbëve të diamantit realizon një prerje të shpejtë dhe të lëmuar

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është bazuar në Ligjin 162 datë 23. 12 2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Neni 82 “*Formulari përbledhës i vetë-deklarimit*”, dhe në VKM-në nr. 285 datë 19. 05. 2021 i ndryshuar, “*Për Miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Neni 26 “*Formulari përbledhës i vetëdeklarimit*” dhe Neni 40 “*Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave*”. Me anë të këtij kriteri AK kërkon të jetë i siguruar për gjendjen aktuale të OE, për përbushjen me sukses të kësaj kontrate.

b. *Formularin e Ofertës sipas Shtojcës 1;*

c. *Listën e Çmimeve sipas Shtojcës 2.*

Argumentimi: Kriteret e mësipërm (b, c) janë bazuar në VKM-në nr. 285 datë 19. 05. 2021 i ndryshuar, “*Për Miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Neni 15, “*Përbajtja e dokumenteve standarde të tenderit*”, pika 2.

ç. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është bazuar në Ligjin 162 datë 23. 12 2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Neni 83 “*Sigurimi i ofertës*”, dhe në VKM-në nr. 285 datë 19. 05. 2021 i ndryshuar, “*Për Miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Neni 30 “*Sigurimi i ofertës*”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (Kriteret e Përgjithshme të Për zgjedhjes/Kualifikimit).

2.1.1 Të jetë qartësisht e specifikuar në QKB, se objekti i veprimitarisë së operatorit ekonomik është i njëjtë ose “ekuivalent” me objektin e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 162 datë 23. 12. 2020 “*Për Prokurimin Publik*”, neni 77 “*Kërkesat për kualifikim*”, pika “*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në*”:

a) *përshtatshmérinë për të kryer veprimitarinë profesionale;*” dhe pika 2: “*Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimi profesional, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë... ”, si dhe në VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 40 “*Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave*”, pika 5: “*Për të provuar përshtatshmérinë për të kryer veprimitarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:**

a) licencat profesionalë për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; ”.

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet 2022,2023, me një vlerë jo me te ulet se 40% e fundit limit te ketij prokurimi. **Kjo Kërkesa konsiderohet e përmbrushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.**

2.2.2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancin vjetor, për vitin financiare 2022, 2023 shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në përputhje me Ligjin Nr. 162 datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik”, nen 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3: “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhilo vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japid informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të jet e madhe se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës... ”bazuar ne nenin 43 te VKM-në Nr. 285 datë: 19. 05. 2021 ”“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore kërkohet bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30. 01. 2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatuveshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

Bilancet per dy vitet e fundit janë kerkuara bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe sherben per te njohur gjendjen financiare te operatoreve ekonomik ofertues

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Furnizime te meparshme te ngjashme me nje vlere prej 20% te fondit limit te objektit te prokurimit, te realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, vertetuar me dokumentacionin vertetues si me poshte:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatile të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatile të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatile, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që sherbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kontrata e ngjashme eshte e domosdoshme per te vertetuar eksperiencen e operatoreve ekonomik ofertues, me qellim qe te garantohet zbatimi i kontrates me sukses.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikata të vlefshme:

- ISO 9001:2015 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë,

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet. Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njojur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme eshte vendosur bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter eshte gjykuar si i domosdoshem, pasi kjo certifikate garnaton autoritetin kontraktor qe operatoret ekonomik ofertues ofrojne cilesine ne furnizimin e mallrave objekt kontrate.

Njesia e prokurimit